REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
NR. 4536 VENDIMI

4536

# V E N D I M
## " PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK "

Sot me daten 30.5.94 ne Gjykaten e rrethit Tirane përpara me je gjyqtares se kesaj gjykate Anila Cefo u paraqiten kerkuesit Sejrije Dekaj e bija e Halitit dhe Nazmijes,dtl 1950,lindur ne Durres e banuese ne Durres Lagj Nr.9 Rruga " A.Goga" dhe Ylli Jaubelli i biri i Bahrit dhe Drites,dtl 1959,lindur ne Berat dhe banues ne Durres Lagj Nr. 10 Rruga "A.Goga" duke kerkuar regjistrimin si person juridik te shoqerise me përgjegjesi te kufizuar te quajtur "THE STAR"

Pasi studiova materialet e paraqitura dhe kerkesen e tyre

## K O N S T A T O V A

Kerkesa e paraqitur ne Gjykate nga ana e kerkuesve te mesipërm per regjistrimin si person juridik te shoqerise me përgjegjesi te kufizuar "THE STAR" me administrator Ylli Jaubelli,me kapital themelor te shoqerise 700.000 lek,me seli ne qytetin e Durresit Lagj Nr.10 Rruga "A.Goga",me kohezgjatje mbi 10 vjet dhe me ortak Sejrije Dekaj dhe Ylli Jaubelliu per te ushtruar aktivitet Prodhimin dhe tregtimin e konfeksioneve te ndryshme ne shumice e pakice ne formen e import eksportit si dhe tregtimin e artikujve te ndryshem ushqimor,industrial,pjese kembimi e makineri,lende ndertimi,paisje elektro shtepiake,prodhime gome e plastike,lodra per femije ne shumice e pakice ne formen e import eksportit

## PËR KËTO ARSYE

Ne baze te ligjes Nr.7638 date 19.11.1992 dhe ligjes Nr.7667 date 28.1.1993

## V E N D O S A

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "THE STAR" me seli ne qytetin e Durresit Lagj Nr.10 Rruga "A.Goga" me administrator Ylli Jaubelliu e me ortak Sejrije Dekaj,me kapital themelor te shoqerise 700.000 lek,me kohezgjatje mbi 10 vjet me objekt te veprimtarise Prodhimin dhe tregtimin e konfeksioneve te ndryshme ne shumice e pakice ne formen e import eksportit si dhe tregtimin e artikujve te ndryshem ushqimor,industrial,pjese kembimi e makineri,lende ndertimi,paisje elektro shtepiake,prodhime gome e plastike,lodra për femije ne shumice e pakice ne formen import eksport

Kunder ketij vendimi behet ankim ne shkalle te dyte

Tirane me ____________

G J Y Q T A R E

/ Anila Cefo /

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE
Nr. 4536/1 Vendimit

# VENDIM

## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 17-10- 2006 une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane M. [illegible] mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi:
**Ylli Janbelli**
per depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare "THE STAR" shpk dhe:

## KONSTATOVA

Me vendimin nr.4536 date 30.05.1994 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "THE STAR".

Me vendimin nr.1 date 18.06.2006 te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie eshte vendosur:

- Zmadhimi i kapitalit te nenshkruar nga ortaket ne shumen 2.983.278 leke, pra kapitali i regjistruar dhe i nenshkruar nga ortaket behet perfundimisht **3.683.278 leke**.
- Caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar z. Volf Semini, me numer liçense 48 date 10.02.2000, per hartimin e raportit per shtimin e kapitalit te shoqerise me fitimet e realizuara deri me 31.12.2005.

Sa me lart pasi shqyrtova kerkesen, çmova se:
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 :Per Rregjistrin Tregtar":

# VENDOSA

Pranimin e kerkeses.

Depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit nr.1 date 18.06.2006 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE STAR" shpk, ku eshte vendosur:

-Zmadhimi i kapitalit themeltar ne shumen 2.983.278 leke, pra kapitali themeltar behet perfundimisht **3.683.278 leke**.

-Caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar z. Volf Semini, me numer liçense 48 date 10.02.2000.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQSOR TIRANE
Nr. 4536/1 Vendimit

# V E N D I M

## I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me date 17.10. 2006 une Gjyqtare e Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane [illegible] mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi:
Ylli Jambelli
per depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise tregtare "THE STAR" shpk dhe:

## K O N S T A T O V A

Me vendimin nr.4536 date 30.05.1994 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Tirane eshte regjistruar si person juridik shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "THE STAR".

Me vendimin nr.1 date 18.06.2006 te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie eshte vendosur:

- Zmadhimi i kapitalit te nenshkruar nga ortaket ne shumen 2.983.278 leke, pra kapitali i regjistruar dhe i nenshkruar nga ortaket behet perfundimisht 3.683.278 leke.
- Caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar z. Volf Semini, me numer liçense 48 date 10.02.2000, per hartimin e raportit per shtimin e kapitalit te shoqerise me fitimet e realizuara deri me 31.12.2005.

Sa me lart pasi shqyrtova kerkesen, çmova se:
Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

## PER KETO ARSYE

Ne baze te ligjit nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe te ligjit nr.7667 date 28.01.1993 :Per Rregjistrin Tregtar":

**V E N D O S A**

Pranimin e kerkeses.
Depozitimin prane regjistrit tregtar te vendimit nr.1 date 18.06.2006 te asamblese se ortakeve te shoqerise "THE STAR" shpk, ku eshte vendosur:

-Zmadhimi i kapitalit themeltar ne shumen 2.983.278 leke, pra kapitali themeltar behet perfundimisht 3.683.278 leke.

-Caktimi i ekspertit kontabel te autorizuar z. Volf Semini, me numer liçense 48 date 10.02.2000.

Urdherohet zyra e regjistrit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne skeden e shoqerise.

GJYQTARE

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANE
NR. 45361/z Vendimit

VENDIM
I GJYQTARIT TE VETEM

Ne Tirane sot me dt. 06.12.2006 (dymije e gjashte) ne Gjykaten e rrethit gjyqesor Tirane une gjyqtarja e kesaj gjykate A. Dumbarelli (Coco) mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur prane kesaj gjykate nga administratori i shoqerise "The Star"SH.P.K. Ylli Janbelli me objekt:
"Per depozitimin ne regjistrin tregtar prane gjykates te Proces-Verbalit dhe te Vendimit nr.2, te dates 03.11.2006 te Asamblese se Ortakeve te Shoqerise "The Star "SH.P.K. per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nga fitimet e realizuara si dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2005, sipas statutit te shoqerise "The Star"Sh.p.k., ne baze te ligjit nr.7667, dt.28.01.1993 "Per regjistrin tregtar dhe…".

Pasi shqyrtova kete kerkese,

**KONSTATOVA:**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "The Star"SH.P.K. eshte regjistruar si person juridik me vendimin Nr.4536, date 30.05.1994 me administratore Z. Ylli Janbelli , me seli Durres, me kapital themeltar 700.000 leke qe zoterohet nga ortaket e shoqerise 49% nga Ylli Janbelli dhe 51 % nga Sejrije Dekaj.

Me vendimin nr.1, date 18.06.2006, si dhe me vendimin nr.2, date 03.11.2006 te asamblese se jashtezakonshme te shoqerise "The Star"Sh.p.k. eshte vendosur zmadhimi I kapitalit te shoqerise nga fitimet e realizuara dhe rezervat e krijuara deri me 31.12.2005 e te pa shperndara prej 2.983.000 leke, sipas raportit te hartuar nga eksperti kontabel. Zmadhimi I kapitalit te shoqerise do te behet duke rritur numerin e pjeseve te kapitalit. Sa me lart pasi shqyrtova kerkesen, cmova se:

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

**PER KETO ARSYE**
Ne mbeshtetje te Statutit te Shoqerise "The Star"Sh.p.k. dhe ligjit nr.7667 date 28.1.1993 «Per regjistrin tregtar» dhe Ligjit nr.7638 date 19.11.1992 « Per shoqerite tregtare»

**VENDOSA**
Pranimin e kerkeses.
Depozitimin prane regjistrit tregtar te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, te vendimit nr.2, date 03.11.2006 te asamblese te jashtezakonshme te shoqerise "The Star"Sh.p.k.

Durres per zmadhimin e kapitalit themeltar te shoqerise ne shumen prej 2.983.000 leke.

Kapitali themeltar I shoqerise “The Star”Sh.p,k. behet prej 3.683.000 (tremilionegjashteqindetetedhjeteetremije) leke (kapitali themeltar ishte 700.000 leke dhe behet 3.683.000 leke), ku zoterohet nga ortaket e shoqerise.

. Zj. Sejrije Dekaj e cila zoteron 51% te kuotave dhe ne shumen 1.879.000 leke

Z. Ylli Janbelli i cili zoteron 49% te kuotave dhe ne shumen 1.804.000 leke.

.

Urdherohet zyra e regjistrimit tregtar te beje ndryshimet perkatese ne kollonen 3,4 germa_____dhe te behet me vize te kuqe.

***GJYQTARE***

# S T A T U T I

## I SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
## " THE STAR "

Në mbështetje të ligjit "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private dhe nismës së lirë të veprimtarive private e të pavarura dhe privatizimit" Nr.7512 datë 10.08.1991 si dhe dispozitave të tjera përkatëse për krijimin e shoqërive në bazë të pronës private krijohet shoqeria me përgjegjësi të kufizuar "THE STAR" në bazë të akt-themelimit datë ndermjet ortakëve të poshtëshënuar;

1)Z.Sejrie Dekaj,e bija e Halitit dhe Nazmijes,dtl.1958,lindur në Durres dhe banuese në Durrës L.Nr.9,Rr.A.Goga

2)Z.Ylli Jaubelli,i biri i Beharit dhe i Drites,dtl.1959,lindur në Berat dhe banues në Durrës L.Nr.18,Rr.A.Goga

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar do të zhvillojë aktivitetin e saj ekonomik sipas dispozitave të këtij statuti.

### Kreu I
### Dispozita të përgjithshme

### NENI 1

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "THE STAR" eshtë person juridik privat.Shoqëria e ka qendrën e saj në qytetin e Durrësit L.18,Rr.A.Goga, pranë Fabrikës së Mobiljeve.Shoqëria mund të formojë degë ose përfaqësi të tjera brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.Qendra e shoqërisë transferohet me pëlqimin e ortakëve me vendim të Asamblesë.

### NENI 2

Shoqëria "THE STAR" e zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar si dhe me atë tregtar nderkombëtar si dhe me aktet themeluese të saj që janë kontrata dhe ky statut,që bashkalidhet dhe bëhet pjesë përbërëse e kontratës.

### NENI 3

Shoqëria ka vulën e saj në formën e rrumbullakët me mbishkrimin "THE STAR" në mes të vulës dhe tre yje të vegjël mbi këtë mbishkrim.

### NENI 4

Jetëgjatësia e shoqërisë "THE STAR" eshtë përcaktuar mbi dhjetë vjet duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar.Jetëgjatësia e saj mund të zgjatet ose të shkurtohet me pëlqimin e krijuesve të shoqërisë.

### NENI 5

Shoqëria "THE STAR" do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj:

a)Prodhimin dhe tregtimin e konfeksioneve të ndryshme me shumicë e pakicë në formën import-eksport.

b)Do të kryej tregtimin e artikujve të ndryshëm ushqimor,industrial, pjesë këmbimi e makineri,lëndë ndërtimi,paisje elektro-shtëpiake

prodhime gome e plastike,lodra për fëmijë,me shumicë e pakicë në formën e import-eksportit.

c)Të kryejë cdo veprimtari tjetër në interes dhe në dobi të firmës që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe i sigurojnë fitime të ligjshme shoqërisë.

Kreu II

Të drejtat dhe detyrat e palëve

NENI 6

Ortakët gëzojnë këto të drejta kryesore:

-Drejtimin e drejtëpërdrejtë të shoqërisë në përputhje me kontratën dhe statutin;

-Pjesëmarrjen në rezultatet e veprimtarisë ekonomike të shoqërisë sipas kontratës dhe statutit;

-Pjesëmarrjen vetë ose me përfaqësuesit e tyre në organet drejtuese të shoqërisë që mund të krijohen me marreveshje ndermjet palëve;

-Njohjen me të gjitha të dhënat që kanë të bëjnë me veprimtarinë ekonomike e financiare të shoqërisë dhe me gjithë dokumentat e përpunuara prej saj;

-Heqjen dorë nga shoqëria duke i afruar në fillim interesat e veta ortakëve të tjerë.

NENI 7

Ortakët kanë këto detyrime kryesore;

-Të depozitojnë kuotën e tyre ose dhe kuota suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin;

-Të japin të dhëne të domosdoshme për realizimin e cdo objektivi të vecantë që lidhet me veprimtarinë e shoqërisë;

-Të kryejnë detyrat e caktuara për realizimin e veprimtarisë së shoqërisë

NENI 8

Secili ortak nëse heq dorë nga shoqëria duhet të njoftojë vendimin e vet me shkrim që tre muaj më parë.Heqja dorë nuk e cliron palën nga detyrimet e marra më parë ndaj shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet e shoqërisë ndaj palës që heq dorë.Pala që heq dorë detyrohet t'ja afrojë interesat e veta palës tjetër dhe kur ortakët nuk pranojnë këtë blerje mund t'ja u shesë palëve të treta,por jo me cmim më të ulët nga ai ofruar ortakëve të vet.

Kreu III

Kushtet ekonomike

NENI 9

Veprimtaria e shoqërisë "THE STAR" realizohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancin e saj.Shoqëria "THE STAR" mban kontabilitet të rregullt sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 10

Kapitali fillestar i shoqërisë private me përgjegjësi të kufizuar "THE

STAR" përbëhet nga 700.000 lekë i ndarë ky kapital si më poshtë midis ortakëve:

…0.000 lekë i përkasin ortakut Sejrie Dokaj ose 51%

…000 lekë i përkasin ortakut Ylli Jaubelli ose 49%

[illegible]at janë depozituar në bankën ku është celur dhe llogaria përkatëse e shoqërisë "THE STAR".

Kapitali fillestar është i ndarë në 70 kuota prej 10.000 lek të ndarë ndërmjet ortakëve:

Sejrie Dokaj 36 kuota dhe Ylli Jaubelli 34 kuota.

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.Në librin e llogarisë së shoqërisë krijohet "fondi themeltar" i ortakëve ku regjistrohen kapitalet e vëna nga secili ortak.Ortakët nuk kufizohen në rritjen e kontributit të tyre,në fitimin që rrjedh nga veprimtaria e tyre.Mënyra e rritjes së kapitalit themeltar të ortakëve përcaktohet në statut.

-Transferimi i aksioneve nominative kërkon lejo me shkrim nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë mbi 50% të kapitalit themelor.

-Parësia në transferimin e aksioneve nominative i takon aksionerëve të shoqërisë sipas rradhës së paraqitjes së kërkesës dhe në rast paraqitje të menjëhershme eshtë Asambleja e ortakëve ajo që përcakton rradhën.Asambleja cakton blerësin brenda tre muajve duke llogaritur afatin nga data e paraqitjes së ofertës të transferimit të aksioneve.Në rast se Asambleja nuk cakton brenda kësaj periudhe blerësin,pronari i aksioneve mund ti shesë ato cdo personi fizik a juridik me cmim të lirë por jo më të ulët se cmimi i ofruar ortakëve.Në rast se blerësi caktohet nga Asambleja ortakëve cmimi i shitjes së aksioneve do të caktohet sipas vlerës aktuale të bilancit të shoqërisë.

NENI 11

Shoqëria"THE STAR" eshtë pronare e pasurisë së saj dhe ka të drejten e përdorimit dhe disponimit të kësaj pasurië në përputhje me qëllimin e veprimtarisë që kryen.

NENI 12

Fitimi i realizuar nga shoqëria pasi shlyhen detyrimet ndaj të tretëve, pasi zbriten fondet e detyruara dhe likujdohen taksat e tatimet në masën e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar si dhe detyrime të tjera rezulton fitimi neto,i cili do të ndahet ndermjet ortakëve në përputhje përpjestimore me kontributin e kapitalit themeltar.

1.Sejrie Dokaj merr fitim nga shoqëria në masën 51%

2.Ylli Jaubelli merr fitim nga shoqëria në masën 49%

NENI 13

Ortakët nuk mund te përdorin pasurinë e shoqërisë për qëllime të tjera përvec atyre të përcaktuara në kontratë dhe statut,pa unanimitetin dhe pëlqimin e ortakëve.Ortakët e shoqërisë përgjigjen vetëm për detyrimet e saj.Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ata të kenë pavarësi ligjore dhe

të drejta pronësie jashtë kësaj shoqërie.Ata nuk përgjigjen për detyrimet e njëri-tjetrit nga veprimtaritë e tjera.

Pjesëmarrja e ortakëve në humbje nga veprimtaria e shoqërisë "The [illegible] të jetë në të njejtën masë me fitimin nga veprimtaria e saj.

Asnjëri nga ortakët nuk ka të drejtë të ushtrojë për llogari të ti ajo të të tretëve një aktivitet konkurent me atë të shoqërisë"THE STAR" brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe nuk ka të drejtë të marrë pjesë si ortak me përgjegjësi të kufizuar me firma të tjera konkurente përvec atyre që ortakët ushtrojnë ose autorizimit të dhënë nga Asambleja.

NENI 14

Rezultatet financiare të veprimtarisë së shoqërisë "THE STAR" caktohen në bazë të bilanceve mujore,tremujore dhe vjetore.Cdo vit financiar fillon me 1 Janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor,përvec vitit të pare financiar që do të mbyllet në 31 Dhjetor 1994.Brenda tre muajve të fundit të vitit financiar Asambleja duhet të miratojë bilancin vjetor,relacionin e administratorit,inventarin,kontabilitetin vjetor.

NENI 15

Negoftëse bilanci i shoqërisë nuk del me fitim por me humbje humbjet do të mbulohen me shumën e mjeteve të investuara për krijimin e shoqërisë.Në rast se humbjet nuk mund të mbulohen me mjetet e krijimit të shoqërisë, atëhere shoqërisë i hapet procedura e likujdimit,përkatësisht e falimentimit.

NENI 16

Shoqeria e ushtron aktivitetin e saj të përcaktuar në këtë statut në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.Për kryerjen e kësaj veprimtari shoqëria krijon dhe filiale,sektorë e aktivitete të tjera ndihmëse në funksion të veprimtarisë së saj.

NENI 17

Shoqëria private "THE STAR" ka të gjithe tagrat në qarkullimin juridik me personat e tretë.

NENI 18

Për novoja të aktivitetit të saj shoqeria "THE STAR" mund të celë llogari në lekë dhe në valutë si në Bankën Tregtare Shqiptare,në Bankën e Kursimeve të Shqipërisë si dhe në cdo bankë tjetër private cpo shtetërore e njohur me ligj.

NENI 19

Shoqëria e zhvillon veprimtarinë e saj të përcaktuar në këtë statnt duke përcaktuar fondet e mëposhtme:

- Fondi Themelor
- Fondi Rezervë
- Fonde të tjerë

NENI 20

Shoqëria "THE STAR" fiton zotësinë juridike për të vepruar me regjistrimin e saj si person juridik privat në Gjykatën e Rrethit të Tiranës dhe organet përkatëse financiare.

Kreu IV

Organet drejtuese

NENI 21

Organi vendimor i shoqërisë "THE STAR" eshtë Asambleja e ortakëve. Asambleja përbëhet nga të gjithë ortakët që veprojnë në bazë të të gjitha dispozitave të këtij statuti. Vendimet e saj të marra në përputhje me ligjet dhe me statutin janë të detyrueshme për të gjithë ortakët edhe në rastin kur nuk marrin pjesë në marrjen e tyre. Asambleja e ortakëve vendos në unanimitet për ndryshimin e dispozitave të kontratës dhe statutit, për rritjen ose pakësimin e kapitalit, për miratimin e programit vjetor të veprimtarisë së shoqërisë, për pushimin e veprimtarisë së saj si dhe për cdo ceshtje tjetër që e sheh të arësyeshme.

Asambleja zgjedh administratorin e shoqërisë me vota të hapura. Administrator i shoq. "THE STAR" eshtë Z. Xili Jaubelli.

NENI 22

Mbledhja e Asamblesë zhvillohet një herë në tre muaj, por jo më pak se një herë në vit, pas mbylljes së periudhës ushtrimore. Në raste të vecanta mund të thirret mbledhje e jashtëzakonshme e Asamblesë.

NENI 23

Thirrja e Asamblesë bëhet nëpërmjet njoftimit me shkrim, që përmban ditën, orën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes, të cilën e dërgon jo më pak se tridhjetë ditë nga data e caktuar për mbledhje. Ortakët mund të përfaqësohen nga një ortak tjetër ose edhe nëpërmjet një akti përfaqësimi me shkrim.

NENI 24

Asambleja në mbledhjen e zakonshme quhet e thirrur rregullisht kur marrin pjesë aq ortakë të cilët përfaqësojnë vetë ose me përfaqësim shumicën e kapitalit të shoqërisë. Vendimet e saj janë të vlefshme kur votohet "pro" shumica absolute e kapitalit prezent ose të përfaqësuar. Në rast barazim votash propozimi quhet i refusuar.

NENI 25

Asambleja në mbledhjen e jashtëzakonshme merr vendime të vlefshme me unanimitet të ortakëve.

NENI 26

Asambleja kryesohet nga administratori i saj, i cili e përfaqëson atë në marrëdhëniet me të tretët si dhe ka të drejtën e firmës. Asambleja emëron një sekretar, që mban proces-verbalet e mbledhjeve. Vendimet e Asamblesë vërtetohen nga proces-verbali i firmosur nga administratori dhe sekretari.

NENI 27

Për drejtimin e veprimtarisë së shoqërisë "THE STAR" Asambleja ortakëve

mund të emërojë një këshill administrativ. Mënyra e funksionimit dhe kompetencat e tij caktohen nga Asambleja e ortakëve.

NENI 28

Asambleja e ortakëve emëron komisionin e kontrollit. Në periudha të caktuara ... ohe ky komision bën kontrollin e veprimtarisë së shoqërisë dhe infor... asamblenë e ortakëve.

NENI 29

Për zhvillimin e veprimtarisë së vet shoqëria "THE STAR" mund të punësojë persona të tjerë. Marëdhëniet e punës me këta persona rregullohen nëpërmje... kontratës së punës. Për çeshtje që nuk rregullohen nga kontrata e punës zbatohen dispozitat e legjislacionit të punës.

NENI 30

Shndërrimi i shoqërisë "THE STAR" në një shoqëri kolektive apo komandite bëhet me vendim unanim të Asamblesë të ortakëve. Ky shndërrim eshtë i dety... rueshëm për shoqërinë kur kapitali themeltar bie nën limitin e domosdoshë... për shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar të parashikuar në Kodin Tregtar Shqiptar.

NENI 31

Administratori ka këto kompetenca:

Drejton të gjithë veprimtarinë e shoqërisë. Organizon punën në të gjitha drejtimet dhe ka të drejtë të veprojë në emër dhe për llogari të shoqëris... Miraton bilancin vjetor dhe raportin financiar të shoqërisë, vendos për fo... mën e organizimit të shoqërisë, të ndarjes së fitimit, të përdorimit të tij dhe për mbulimin e humbjeve duke zbatuar vendimet e Asamblesë. Përfaqëson shoqërinë dhe në raste të veçanta mund ta përfaqësojë personi i autorizuar prej tij. Emëron dhe shkarkon persona të punësuar në këtë shoqëri. Lid... marrëveshje kontraktore me firma e shoqëri të tjera private brenda dhe ja... shtë vendit. Gjithashtu ai ndjek zbatimin e detyrave ekonomike, financiare të veprimtarisë së shoqërisë si dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Merret me problemet administrative të shoqërisë.

Kreu V

Marëdhëniet e punës

NENI 32

Marëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen në përputhje me kontratën e krijimit të shoqërisë, legjislacionin shqiptar të punës dhe me këtë statut. Me kontratën e punës rregullohen këto çeshtje:

- Kushtet dhe mënyra e marëdhënieve të punës;
- Të drejtat dhe detyrimet e palëve;
- Fillimi dhe vendi i punës;
- Caktimi i kohës punës, puna jashtë kohës normale, festat dhe ditët e pushimit;
- Mbrojtja në punë dhe kushtet e punës;
- Ndërprerja e marëdhënies së punës.

NENI 33

Punonjësi për punën e tij do të marrë pagën e tij në varësi me rezultatet e arritura në punë,në përputhje me kontratën e punës.

NENI 34

Punonjësi eshtë personalisht përgjegjës për kryerjen e punëve të caktuara Po kështu ai përgjigjet materialisht për dëmet që mund t'i shkaktojë shoqërisë gjatë punës.Ai ruan sekretet e punës si dhe dokumentet dhe veprimet që janë shpallur sekret nga administratori i shoqërisë.Punonjësi duhe të kryejë detyrat brenda kuahtove të kontratës së punës,rregullores së brendshme të shoqërisë me ndergjegje,cilësi,në mënyrë të ligjshme dhe profesionale.

Kreu VI

Mbyllje e shoqërisë

NENI 35

Veprimtaria e shoqërisë "THE STAR" mbyllet;
-Në rastet e përcaktuara në legjislacionin shqiptar;
-Kur kapet procedura e likujdimit plotësisht,përkatësisht e falimentimit;
-Me vendim të Asamblesë së ortakëve.

NENI 36

Kur veprimtaria e shoqërisë mbyllet me vendim të Asamblesë së ortakëve ajo shpërndahet në formën e riorganizimit ose të likujdimit.Shoqëria i jep fund veprimtarisë së saj në castin e miratimit të bilancit të likujdimit nga Asambleja e ortakëve.

NENI 37

Kur shoqëria "THE STAR" i jep fund veprimtarisë së saj pasuritë që janë vënë në dispozicion me të drejtë përdorimi i kthehen palës pronare,kurse mjetet materiale dhe financiare të fituara si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë e të filialeve si dhe fondet e saj ndahen ndermjet ortakëve në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themelor.

NENI 38

Cdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndermjet palëve ,ortakëve të shoqërisë ose ndermjet shoqërisë dhe të tretëve do të zgjidhen sipas legjislacionit shqiptar dhe organi që do të zgjidhë këto mosmarrëveshje do të jetë Gjykata e Rrethit Durres ose cdo organ tjeter kompetent sipas legjislacionit shqiptar.

NENI 39

Ndryshimet dhe plotësimi i këtij statuti bëhen në të njejtën mënyrë e procedurë me të cilën eshtë nxjerrë ky statut.

Ky statut hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij nga ortakët.

NENI 40

Ky statut u përpilua në Durres,me datën                 në kater kopje të njejta,në gjuhën shqipe,që kanë të njejtën vlerë ligjore.

O R T A K Ë T

Sejrie Dekaj                                        Ylli Jaubelli

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
NOTERIA DURRES
Nr.rep. 4587 Nr.kolek. 2563

V E R T E T I M

Sot,me datën nëntëmbëdhjetë të muajit maj të vitit njëmijënëntëqindenën tëdhjetëkatër (19.05.1994),ditën e enjte,në Zyrën noteriale Durres para meje Elda Mihal Puli,notere në qytetin e Durresit u paraqitën personalisht Sejrie Dekaj,e bija e Halitit dhe e Nazmijes,dtl.1958,lindur në Durres dhe banues në Durres,me zotësi juridike për të vepruar dhe Ylli Jaubelli,i biri i Baharit dhe i Dritës,dtl.1959,lindur në Berat dhe banues në Durrës,me zotësi juridike për të vepruar,për identitetin e të cilëve u sigurova në bazë të letërnjoftimit personal,të cilët me vullnetin e tyre të lirë nënshkruan këtë statut.

Për sa më sipër unë noterja vërtetoj.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E DREJTËSISË NOTERIA DURRËS

N O T E R E
(Elda Puli)

# A K T - T H E M E L I M I
## PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË PRIVATE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR " THE STAR "

Sot,me datë 19.05. 1994,në Durres hartohet ky akt-themelimi ndermjet personave të poshtëshënuar;

1. Z.Sejrie Dekaj,e bija e Halitit dhe Nazmijes,e dtl.22.07.1958,lindur në Durres dhe banuese në Durrës L.Nr.9,Rr.A.Goga
2. Z.Ylli Jaubelli,i biri i Beharit dhe i Dritës,i dtl.8.05.1959,lindur në Berat dhe banues në Durres L.Nr.18,Rr.A.Goga

të cilët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë ranë dakort si mëposhtë;

NENI 1

Të krijojnë një shoqeri me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.) me emrin THE STAR.Qendra e shoqërisë do të jetë në Durrës,Lagja 18,Rruga A.Goga, pranë Fabrikës së Mobiljeve.

Shoqëria"THE STAR" mund të ketë filialet,degët e zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

NENI 2

Shoqëria "THE STAR" do të ushtrojë veprimtarinë e saj mbi dhjetë vjet. Ajo mund të zgjatet në kohë ose të mbyllet me marrëveshje të vetë ortakëve.

NENI 3

Shoqëria "THE STAR" është person juridik shqiptar.Veprimtaria e saj rregullohet me dispozitat e kësaj kontrate dhe statuti që eshtë pjesë përbërëse e kontratës,nga legjislacioni shqiptar dhe nga normat tregtare ndërkombëtare.

NENI 4

Shoqëria private me përgjegjësi të kufizuar "THE STAR" do të ketë për objekt të veprimtarisë së saj:

a)Prodhimin dhe tregtimin e konfeksioneve të ndryshme me shumicë e pakicë në formën import-eksport.

b)Do të kryej tregtimin e artikujve të ndryshëm ushqimor,industrial,pjesë këmbimi e makineri,lëndë ndertimi,paisje elektro-shtëpiake,prodhime gome e plastike,lodra për fëmijë,me shumicë e pakicë në formën e import-eksport.

c)Si dhe cdo veprimtari tjetër në interes dhe në dobi të firmës që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar dhe i sigurojnë fitime të ligjshme shoqër.

NENI 5

Kapitali fillestar i shoqërisë private me përgjegjësi të kufizuar "THE STAR" përbëhet nga 700.000 lekë i ndarë ky kapital si më poshtë midis ortakëve:

360.000 lekë i përkasin ortakut Sejrie Dekaj ose 51%

340.000 lekë i përkasin ortakut Ylli Jaubelli ose 49%

Të hollat janë depozituar në bankën ku është celur dhe llogaria përkatëse e shoqërisë "THE STAR"

Kapitali fillestar është i ndarë në 70 kuota prej 10.000 lek të ndarë nde mjet ortakëve:

Sejrie Dekaj 36 kuota dhe Ylli Jaubelli 34 kuota.

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

Në librin e llogarisë së shoqërisë krijohet "fondi themeltar" i ortakëve ku regjistrohen kapitalet e vëna nga secili ortak.Ortaket nuk kufizohen në rritjen e kontributit të tyre,në fitimin që rrjedhin nga veprimtaria e tyre.Mënyra e rritjes së kapitalit themeltar të ortakëve përcaktohet në statut.

NENI 6

Shoqeria ka të drejtë të ketë llogari në valutë në bankat shqiptare dhe të huaja në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ka të drejtë të disponojë lirisht mjetet monetare valutë dhe lekë të depozituara nga aktiviteti i saj.

NENI 7

Fitimi i realizuar nga shoqeria pasi shlyhen detyrimet ndaj të tretëve ,pasi zbriten fondet e detyruara dhe likujdohen taksat e tatimet në masën e përcaktuar në legjislacionin shqiptar si dhe detyrime të tjera rezulton fitimi neto,i cili do të ndahet ndermjet ortakëve në përputhje për pjestimore me kontributin e kapitalit themeltar.

Sejrie Dekaj merr fitim nga shoqeria në masën 51%

Ylli Jaubelli merr fitim nga shoqeria në masën 49 %

NENI 8

Oratket nuk mund të përdorin pasurinë e shoqërisë për qëllimetë tjera përvec atyre të përcaktuara në kontratë dhe statut,pa unanimitetin dhe pëlqimin e dy ortakëve.

